



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.3083/12 prot.

Datë 08.01.2023

V E N D I M
Nr. 15 /2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.01.2023, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të KPP nr. 1376/2023, datë 28.12.2023, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-87566-11-14-2023 me objekt “Blerje dru zjarri, Bashkia Mirditë”, me fond limit 2,787,720.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 01.12.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirditë
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Bora-2K” SHPK me NIPT L42004007D dhe adresë: Tiranë, Kamëz, Bathore, Rruga “Ismail Qemali”, pikë tregtimi lëndësh drusore me nr. Pasurie 192/49, zona Kadastrale 2066, afër Kuvendi i Junikut
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Mirditë me adresë: Sheshi “Abat Doçi”, Rrëshen
- Subjekte të Interesuar:** Operatori ekonomik “Xheksoni-04” SHPK me NIPT K39010090G dhe adresë: Rrëshen, SHESHAI, Lagjja "Nokaj", banesë private 2-katëshe nr.4, kati parë
- Operatori ekonomik Gjergj Buça p.f me NIPT K31331547R dhe adresë: Durrës, DURRES, Ura Dajlanit
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit

Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datën 28.12.2023, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1376/2023 ku vendosi:

1. *Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Bora-2 K” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-87566-11-14-2023 me objekt “Blerje dru zjarri, Bashkia Mirditë”, me fond limit 2,787,720.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 01.12.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirditë.*
2. *Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Bora-2 K” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-87566-11-14-2023 me objekt “Blerje dru zjarri, Bashkia Mirditë”, me fond limit 2,787,720.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 01.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirditë.*
3. *Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.*
4. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
5. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Bora-2 K” SHPK.*
6. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
7. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 04/2 prot., datë 03.01.2024 protokolluar me tonën nr. 3083/9 prot., datë 05.01.2024 autoriteti kontraktor njofton se e ka zbatuar vendimin e KPP-së nr. 1376/2023 datë 28.12.2023.

I.3. Nga verifikimi rezulton se bashkëlidhur shkresës së mësipërme autoriteti kontraktor ka dorëzuar Vendimin nr. 01, datë 01.03.2024 “Për anulim procedure prokurimi” Objekti: Blerje dru zjarri, Bashkia Mirditë” të titullarit të autoritetit kontraktor si dhe formularin e njoftimit të anulimit të procedurës duke cituar në pikën 6/d të tij “Arsyet e anulimit” se “d) kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj.”

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr. 04/2 prot., datë 03.01.2024 protokolluar me tonën nr. 3083/9 prot., datë 05.01.2024 autoriteti kontraktor njofton se e ka zbatuar vendimin e KPP-së nr. 1376/2023 datë 28.12.2023.

II.2. Nga verifikimi rezulton se bashkëlidhur shkresës së mësipërme autoriteti kontraktor ka dorëzuar Vendimin nr. 01, datë 01.03.2024 *“Për anullim procedure prokurimi” Objekti: Blerje dru zjarri, Bashkia Mirditë*” të titullarit të autoritetit kontraktor si dhe formularin e njoftimit të anulimit të procedurës duke cituar në pikën 6/d të tij *“Arsyet e anulimit”* se *“d) kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anullimin sipas parashikimeve në këtë ligj.”* si dhe nga verifikimet rezulton se autoriteti kontraktor ka anuluar procedurën e prokurimit edhe në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), publikuar në sistem me datë 04.01.2023. Por autoriteti kontraktor nuk i ka bashkëlidhur shkresës dokumentet e reja të tenderit të procedurës së prokurimit që do të rishpallë.

II.3. Sa më lart, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor Bashkia Mirditë nuk e ka zbatuar vendimin nr. 1376/2023 datë 28.12.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit *“E hapur e thjeshtuar”*, me Nr. REF-87566-11-14-2023 me objekt *“Blerje dru zjarri, Bashkia Mirditë”*, me fond limit 2,787,720.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 01.12.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirditë pasi duhet të dërgojë në KPP dokumentet e reja të procedurës së prokurimit që do të rishpallë të cilat duhet të jenë në përputhje me konstatimet e shprehura në vendimin nr. 1376/2023 datë 28.12.2023 të KPP-së.

Për sa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit *“E hapur e thjeshtuar”*, me Nr. REF-87566-11-14-2023 me objekt *“Blerje dru zjarri, Bashkia Mirditë”*, me fond limit 2,787,720.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 01.12.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirditë.
2. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të dërgojë në KPP dokumentet e reja të procedurës së prokurimit që do të rishpallë të cilat duhet të jenë në përputhje me konstatimet e shprehura në vendimin nr. 1376/2023 datë 28.12.2023 të KPP-së.

3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

